STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 16 dhjetor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) JEP FONDET E PARA TE RIMBURSIMIT TE SENDIT (SANDY) QE ARRIJNE NE ME SHUME SE 40 MILIONE DOLLARE

Më shumë se 24 milionë dollarë për heqjen e mbeturinave në Qytetin e Long Biç (Long Beach)

Pothuajse 16 milionë dollarë për Punët Publike të Qarkut të Nasos (Nassau County)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) dha sot rimbursimet e para që kur goditi Uragani Sendi (Sandy), që arrijnë në më shumë se 40 milionë dollarë për të ndihmuar në heqjen e mbeturinave në Qarkun Naso (Nassau County) që u shkaktuan nga dëmi i gjerë i Uraganit Sendi (Sandy). Sot Shteti dha më shumë se 24 milionë dollarë në para të rimbursimeve që do t'i jepen Qytetit të Long Biç (Long Beach) dhe pothuajse 16 milionë dollarë do t'u jepen Punëve Publike të Qarkut të Nasos (Nassau County) për të ndihmuar në heqjen e mbeturinave që paraqesin shqetësime publike dhe një rrezik të shëndetit publik në ato komunitete që u prekën më shumë nga stuhia.

Guvernatori vizitoi Long Biç (Long Beach) sot për të dhënë këto fonde.

"Sot jemi duke dhënë ndihmën e parë federale për rajonet e goditura më rëndë të Shtetit të Nju Jorkut (New York State) ndërsa vazhdojnë të rimëkëmben nga dëmi," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Këto para në mënyrë të ndjeshme do të ndihmojnë banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) që të rindërtojnë komunitetet në Long Ajlënd (Long Island) dhe anembanë rajoneve të prekura. Me mbërritjen e ndihmës tjetër, Nju Jorku (New York) do të vazhdojë të shkojë përpara dhe të rindërtohet më i fortë sesa më parë."

Këto rimbursime sigurojnë shumat e mëposhtme për pushtetet vendore të Long Ajlënd (Long Island):

• Qyteti i Long Biç (Long Beach) do të marë 24,315,825 dollarë për heqjen e mbeturinave në të gjithë qytetin
• Punët Publike të Qarkut të Nasos (Nassau County) do të marrin 15,917,989 dollarë për heqjen e mbeturinave

Zyrtari i Qarkut Naso (Nassau County) Ed Mangano tha, "Qarku Naso (Nassau County) u godit më rëndë nga Uragani Sendi (Sandy) dhe familjet e komunitetet tona nuk janë fare pranë një rimëkëmbje të plotë. Këto fonde nga FEMA do të bëjnë shumë për të na ndihmuar që të pastrojmë dhe të heqim mbeturinat e

rrezikshme, në mënyrë që të mund të pastrojmë shtëpitë, rrugët dhe lagjet tona dhe të jemi gati për rindërtim. Falënderoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për përkushtimin e tij të vazhdueshëm ndaj Qarkut Naso (Nassau County) dhe FEMA-n për këto fonde të rëndësishme."

Administratori i Qytetit të Long Biç (Long Beach) Xhek Shnirman (Jack Schnirman) tha, "Uragani Sendi (Sandy) ka shkaktuar shkatërrim të tmerrshëm në qytetin tonë. Stuhia zhduku rrugët, plazhet dhe shtëpitë tona, duke lënë pas plehra dhe mbeturina që janë penguese dhe të rrezikshme. Fondet e siguruara nga FEMA do të ndihmojnë Long Biç (Long Beach) që të pastrohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Eshtë një rrugë e gjatë drejt rimëkëmbjes, por jemi mirënjohës për ndihmën nga Governatori Kuomo (Cuomo) sot."

Rimbursimi i sotëm u dha pas një procesi të bashkërenduar të kërkesës me zyrtarë shtetërore dhe federalë. Një Ndërlidhës Shtetëror i Ndihmës Publike punoi me Bashkërenduesin e FEMA-s për Ndihmën Publike për të ndihmuar pushtetet vendore që të hartonin një kërkesë duke dokumentuar se ç'farë pune ishte bërë tashmë dhe ç'farë pune ende duhet bërë në të ardhmen për t'u rimëkëmbur plotësisht nga dëmi i shkaktuar nga stuhia. Ndihmë Publike tjetër pritet për të kompensuar kostot e qarkut për heqjen dhe eleminimin e mbeturinave.

Long Biç (Long Beach) dhe Qarku Naso (Nassau County) do t'i përdorin këto fonde për kosto të ndërtimit dhe të shkatërrimit, heqjen e rërës dhe të mbeturinave bimore, si dhe heqjen, prerjen, transportimin dhe eleminimin e pemëve.

Programi i Ndihmës Publike të FEMA-s ka miratuar pothuajse 16 milionë dollarë për të rimbursuar Qarkun Naso (Nassau County) për 75 përqind të kostos së kohës shtesë për 270 punonjës dhe marrjen me qira të prerësave industrialë të drurit për të pakësuar vëllimin e mbeturinave.

Që heqja e mbeturinave të kualifikohet, dëmi duhet të jetë rezultat i drejtpërdrejtë i Uraganit Sendi (Sandy) dhe puna duhet të ketë qënë e nevojshme për të:

• Eleminuar një kërcënim të menjëhershëm ndaj jetës, shëndetit dhe sigurisë publike,

• Eleminuar kërcënimet e menjëhershme të dëmit të konsiderueshëm ndaj pasurisë së përmirësuar publike dhe private kur masat janë me kosto të efektshme, ose

• Siguruar rimëkëmbjen ekonomike të komunitetit të prekur për përfitimin e të gjithë komunitetit.

Erërat e forta dhe shirat e dendur nga Uragani Sendi (Sandy) rrëzuan pemë, degë pemësh dhe linja të korrentit anembanë rajonit të Nju Jorkut (New York). Mbledhja dhe pastrimi i pirgjeve të mbeturinave ka qënë një nga sfidat më të vështira dhe që kërkon më shumë kohë të rimëkëmbjes. Por pavarësisht nga kjo, pirgjet e mbeturinave po zhduken.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian